



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2020:043143

Datë: 27.10.2020

Numri i dokumentit: 01219806

C.nr.628/20

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Mirlinda Bytyqi Rexhepi, në çështjen juridike kontestimore sipas padisë së paditësve H.G. nga Ferizaj, V.Ç.H. nga Ferizaj, V.H.B. nga Ferizaji, K.B. nga Ferizaj, H.Sh.Z. nga Ferizaji, të cilët i përfaqëson me autorizim av. Arian Hetemi nga Lipjani, kundër të paditurës Komuna Ferizaj Drejtoria e Arsimit, çështja kontestuese pagesa e pagave jubilarë dhe ushqimit, në seancën e mbajtur me datë 23.09.2020, mori ndërsa me datë 20 tetor 2020 përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësve H.G. nga Ferizaj, V.Ç.H. nga Ferizaj, V.H.B. nga Ferizaji, K.B. nga Ferizaji, H.Sh.Z. nga Ferizaji, si e bazuar.

II. DETYROHET e paditura Komuna Ferizaj, që paditësve secilit veç e veç në emër të kompenzimit të ushqimit t'ia paguaj shumat dhe atë:

-Paditësi H.G. ti paguaj shumën e përgjithshme prej 1,606,89 €, dhe atë në emër të ushqimit shumën prej 1,212 € për ditët e pranisë në punë prej datës 18.04.2017 deri me datën 11.03.2020, pra për 606 ditë pune, si dhe në emër të shpërblimit jubilar për 25 vite përvojë pune prej 75% të pagës bazë shumën prej 394,89 €.

-Padiësja V.Ç.H. ti paguaj shumën e përgjithshme prej 1.330.44€, dhe atë në emër të ushqimit shumën prej 1,102 € për ditët e pranisë në punë prej datës 18.04.2017 deri me datën 11.03.2020, pra për 551 ditë pune, si dhe në emër të shpërblimit jubilar prej 50% të pagës bazë shumën për 16 vite përvojë pune prej 228.44 €.

Padiësit V.H.B. ti paguaj shumën e përgjithshme prej 1.333.14€, dhe atë në emër të ushqimit shumën prej 1,102 € për ditët e pranisë në punë prej datës 18.04.2017 deri me datën 11.03.2020, pra për 551 ditë pune, si dhe në emër të shpërblimit jubilar prej 50% të pagës bazë shumën për 19 vite përvojë pune prej 231.14 €.

Padiësja K.B. ti paguaj shumën e përgjithshme prej 1,441.42 €, dhe atë në emër të ushqimit shumën prej 1,088 € për ditët e pranisë në punë prej datës 18.04.2017 deri me datën 11.03.2020, pra për 544 ditë pune, si dhe në emër të shpërblimit jubilar prej 75% të pagës bazë shumën për 24 vite përvojë pune prej 353.42 €.

Padiësja H.Sh.Z.ti paguaj shumën e përgjithshme prej 1,330.44 €, dhe atë në emër të ushqimit shumën prej 1,102 € për ditët e pranisë në punë prej datës 18.04.2017 deri me datën 11.03.2020, pra për 551 ditë pune, si dhe në emër të shpërblimit jubilar prej 50% të pagës bazë shumën për 16 vite përvojë pune prej 228.44 €.

III.DETYROHET e paditura që shumat e përcaktuara sikurse në pikën II të dispozitivit t'ua paguaj padiësve secilit veç e veç me kamat ligjore prej 8 % nga dita e pranimit të aktgjykimit deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 1,142.50 euro, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit.

IV. DETYROHEN padiësit që në emër të shtesës së taksës gjyqësore për padi t'i paguajnë solidarisht shumën prej 60 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësit përmes të autorizuarit të tyre kanë paraqitur padi në gjykatë me datë 25.09.2020 dhe i autorizuari i tyre ka deklaruar se mbetet në tersi pranë padisë dhe i propozon gjykatës që pas shqyrtimit dhe administrimit të provave kërkesëpadinë e paditesve ta aprovoje në teresi si të bazuar për faktin se Kontrata Kolektive e Arsimit e dt. 17.04.2017 është nënshkruar nga qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Arsimit dhe në pjesën hyrse të saj përkatësisht në nenin 1 të kësaj kontrate është përcaktuar qartë se kush përfiton nga kjo e që në rastin konkret paditesit e kanë shfrytëzuar këtë të drejtë për faktin se për periudhën 17.04.2020 kanë përvojë pune të mjaftueshme edhe sa i përket shpërblimit jubilarë ashtu si është parapare në këtë kontrate, ky fakt vërtetohet me vërtetimet e lëshuar nga vete e paditura përkatësisht nga shkolla e mesme e ulet në Ferizaj. E ka kundërshton përgjigjen në padi për faktin se e njejtja ka karakter vetëm deklarativ dhe është e pa bazuar në dispozitat e kontratës kolektive të theksuar andaj një përgjigje e tillë ka vetëm për qëllim pengimin dhe shtyrjen e njohjes dhe përmbushjes së këtyre të drejtave. Andaj mbi bazën e këtyre provave e me që paditësit i plotësojnë kushtet e përcaktuara në bazë të kësaj kontrate nga neni 35 par 7 dhe 8, konsideron se kjo e drejt i takon dhe e paditura ka marr për obligim ligjor të zbatoj këtë kontratë të nënshkruar nga dy palët e nga e cila kontratë dalin të drejtat dhe detyrimet e palëve nënshkruese në bazë të nenit 2 par 1.2 të kësaj kontrate me të cilën parashihet se dispozitat e kësaj kontrate kolektive janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në institucione publike dhe private të arsimit parashkollor fillor të mesëm të ulët në shkollë, si dhe të mesëm të lartë në tërë institucionet e Republikës së Kosovës.

Për llogaritjen e shpërblimit jubilarë, shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit propozon ekspertizë gjyqësore nga fusha financiare për faktin se për të nxjerre lartësinë e këtyre shpenzimeve është e nevojshme përllogaritja profesionale dhe duhet pasur njohuri të veçanta në fushën financiare.

I ka kërkuar shpenzimet procedurale.

Përfaqësuesi i të paditurës ka deklaruar se mbetet në tërësi në përgjigjen në padi duke i kundërshtuar pretendimet e palës paditëse, njëkohësisht e kundërshton propozimin e palës paditëse për ekspertin financiar për llogaritjen e pagës jubilarë dhe të shujtës ditore ngase e konsideron se një përllogaritje e tillë nuk paraqet ndërlíkueshmeri të llogaritjes, sa i përket deklaratës se përfaqësuesit të palës paditëse lidhur me ankesën konsideron se përllogaritja e lartësisë së pagave jubilarë duhet të behet konform pikës 8 të nenit 35 të kontratës kolektive ku në mënyrë konkrete është përcaktuar se në cilën bazë të pagës fitohet e drejta e fitimit të pagës jubilarë, nga të gjitha ekspertizat e bëra deri me tani që kanë qenë të propozuara nga

përfaqësuesi i paditësve përlogaritja e pagave jubilarë ka qenë në kundërshtim me dispoziten e lartcekur.

Gjykata me aktvendim procedural ne seancën e datës 23.09.2020 e ka refuzuar propozimin e të autorizuarit të paditësve, për nxjerrjen e provës përmes ekspertizës financiare, për shkak se nuk kemi të bëjmë me një rast të ndërlikuar, ashtu siç ka pretenduar i autorizuari i paditësit me rastin e propozimit të tij, për shkak se për secilin paditëse gjykata ka pasur prova të sakta lidhur me përvojën e punës së paditësve, dhe ditët e pranisë së paditësve në punë si ditë mësimi, përvojë punës e pa kontestuar nga pala e paditur, dhe se me një llogaritje të thjeshtë ka mundur ta precizoj për secilin paditëse shumën që të njëjtëve ju ka takuar për shujtë dhe shpërblim jubilar.

Sipas bindjes së gjykatës, nxjerrja e provës përmes ekspertizave, përbëjnë përjashtim që do të thotë, ekspertizat janë të domosdoshme vetëm kur të vlerësohet se nuk mund të vërtetohet fakti me prova tjera.

Dispozita e nenit 10 par.1 të LPK-së, e obligon gjykatën në këtë mënyrë tekstualisht *“Gjykata ka për detyrë të përpiqet që procedura të zhvillohet pa zvarritje dhe me sa më pak shpenzime.....”*. edhe pse kjo dispozitë e obligon ekskluzivisht gjykatën për respektimin e këtij parimi, megjithatë kjo nuk e përjashton edhe subjektet tjera pjesëmarrëse në procedurë, aq më tepër komunitetin e avokatëve. Kur bëhet fjalë për avokatë, të njëjtit janë obliguar që të jenë të vëmendshëm kur bëhet fjalë për shpenzime dhe atë sipas Kodit të Etikës Profesionale të Avokatit i datës 23 mars 2019, konkretisht neni 22 paragrafi 1 mes tjerash parasheh *“Avokati nuk duhet t'i shkaktojë palës shpenzime të panevojshme.....”*.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes së fakteve ka bërë administrimin e provave si vijojnë: padia C.nr.628/20 e datës 06.04.2020, kontrata e punës lëshuar në emër të paditësit H.G. kontratë pune në emër të V.Ç., kontratë pune për V.H.B., Kontrate Pune për K.B., kontratë punë për H.Sh.Z., vërtetimi lëshuar nga Drejtoria e Shkollës nr.93/20 dt.20.03.2020, vërtetimi nga Drejtoria e Shkollës nr.30/20dt.20.03.2020 vërtetimi nga Drejtoria e Shkollës nr. 60/20 19.03.2020, vërtetimi nga Drejtoria e Shkollës nr. 71/20 e dt 20.03.2020, vërtetimi nga Drejtoria e Shkollës nr. 73/20 e dt 20.03.2020 përgjigja në padi e datës 23.06.2020, aktvendimi dt.09.06.2020, vërtetimi nr.1/09, vërtetimi nr.1/106, vërtetimi nr.1/79, vërtetimi nr.1/49, vërtetimi nr.1/04, bëhet shiqimi në listat e pagave.

Gjykata, pas administrimit të provave, ka bërë shqyrtimin e tyre veç e veç si dhe të ndërlidhura si tërësi mes veti, mbi bazën e bindjes së saj të lirë në kuptim të nenit 8 të LPK-së, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike, se nuk ishte kontestuese në mesë palëve ndërgjyqjësese paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura dhe nga data 17.04.2017 kur dhe ka hyrë në fuqi Kontrata Kolektive deri me datën 27.03.2020 kanë qenë në vendin e punës, respektivisht është vërtetuar prezenca e tyre në vendin e punës në ditët e precizuara për secilin veç e veç, nuk ishte kontestuese edhe lartësia e kërkesëpadiës por kontestuese ishte baza juridike e kërkesëpadiës se a u takojnë paditësve shumat e kërkuara.

Gjykata përmes kontratave të punës të cilat janë administruara ka vërtetuar faktin se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura, por këtë fakt nuk e ka kontestuar as e paditura.

Gjykata me leximin e vërtetimeve nga Gjumnazi ‘,,,,,,,’ për ditët në punë dhe përvojën e punët të paditësve lëshuar nga Drejtoria e Shkollës, ka vërtetuar faktin e ditëve të pranisë të paditësve në vendin e punës nga data 17.04.2017 kur ka hyrë në fuqi Kontrata Kolektive deri me datën 27.03.2020 dhe atë paditësi H.G. për këtë periudhë ka qenë në vendin e punës 606 ditë, paditësi V.Ç.H. për këtë periudhë ka qenë në vendin e punës 551 ditë, V.H.B. për këtë periudhë ka qenë në vendin e punës 551, K.B. për këtë periudhë ka qenë në vendin e punës 544 ditë, H.Sh.Z. për këtë periudhë ka qenë në vendin e punës 551.

Gjykata me rastin e aprovimit të kërkesëpadiës është bazuar në faktin se me Kontratën Kolektive të nënshkruar nga Qeveria e Kosovës-Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, për punëmarrësin Bashkimin i Sindikatave të Pavarura të Kosovës e cila është nënshkruar nga ana e dy palëve dhe në neni 49 të kësaj kontrate përcaktohet se kjo kontratë hynë në fuqi me ditën e nënshkrimit nga palët nënshkruese.

Në pjesën hyrëse respektivisht në nenin 1 të kontratës kolektive është e përcaktuar qartë se kush përfiton nga kontrata kolektive e që në rastin konkret paditësit e kanë shfrytëzuar një të drejtë pasi që të njëjtit përfitojnë nga kjo kontratë për faktin se për periudhën nga data 17.04.2017 deri me datën 28.03.2020, kanë qenë në vendin e punës respektivisht prezenca e tyre në vendin e punës i cili fakt është vërtetuar përmes vërtetimeve të ditëve të punës të lëshuar nga drejtoria e shkollës-Ferizaj andaj sipas nenit 35 par.7 është paraparë që të punësuarve u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë, për një

ditë pune është 2 euro, për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore, andaj gjykata sa i përket aprovimit të lartësisë kërkesëpadiisë në lidhje me ushqimin e ka bazuar duke e llogaritur ditët e pranisë në punë të secilit paditës e duke e shumëzuar me 2 euro për secilën ditë të pranisë së tyre në vendin e punës.

Andaj duke u nisur nga dispozitat ligjore të lart cekura të Kontratës Kolektive, si dhe gjendjes faktike, rezulton që kërkesëpadiia e paditësve është e bazuar ku dhe e ka detyruar të paditurën që paditësve secilit veç e veç tua paguaj shumat e specifikuar në pikën II të dispozitivit, në njërën anë kurse në anën tjetër e paditura nuk e ka përmbushur obligimin siç e ka pasur për detyrim sipas Kontratës Kolektive e datës 17.04.2017, sa i përket mjeteve monetare për ushqim të specifikuar për secilin paditës veç e veç sikurse në pikën II të dispozitivit.

Sa i përket pagës jubilarë gjykata është bazuar në nenin 35 par.8 pika 8.1 dhe 8.2 të Kontratës Kolektive duke u bazuar në vërtetimet e përvojës së punës rezulton që paditësi H.G. ka përvojë pune 25 vite, e cila nuk ka qenë kontestues për të paditurën e që sipas kësaj kontrate për 20 vite të përvojës në punë të punëdhënësi i fundit në vlerë të 75 % të një page bazë, e që duke marr parasysh që paga e paditësit është 526.53 €, siç vërtetohet përmes listë së pagës i bije që në emër të pagës jubilarë paditësit i takon shuma prej 394.89 €, paditësja V.Ç.H. ka përvojë pune 16 vite, e cila nuk ka qenë kontestues për të paditurën ku 10 vite të përvojës në punë te punëdhënësi i fundit në vlerë të 50 % të një page bazë, e që duke marr parasysh që paga e paditëses është 456.89€, siç vërtetohet përmes listë së pagës i bije që në emër të pagës jubilarë paditëses i takon shuma prej 228.44 €, paditësi V.H.B. a ka përvojë pune 19 vite, e cila nuk ka qenë kontestues për të paditurën ku 19 vite të përvojës në punë te punëdhënësi i fundit në vlerë të 50 % të një page bazë, e që duke marr parasysh që paga e paditësit është 462.28€, siç vërtetohet përmes listë së pagës i bije që në emër të pagës jubilarë paditësit i takon shuma prej 231.14€, paditësja K.G. ka përvojë pune 24 vite, e cila nuk ka qenë kontestues për të paditurën e që sipas kësaj kontrate për 20 vite të përvojës në punë te punëdhënësi i fundit në vlerë të 75 % të një page bazë, e që duke marr parasysh që paga e paditësit është 471.23 €, siç vërtetohet përmes listë së pagës i bije që në emër të pagës jubilarë paditësit i takon shuma prej 353.42 €, paditësi H.Sh.Z. ka përvojë pune 16 vite, e cila nuk ka qenë kontestues për të paditurën e që sipas kësaj kontrate për 20 vite të përvojës në punë te punëdhënësi i fundit në vlerë të 50 % të një page bazë, e që duke marr parasysh që paga e paditësit është 456.89 €, siç vërtetohet përmes listë së pagës i bije që në emër të pagës jubilarë paditësit i takon shuma prej 228.44 €

Sa i pretendimit të përfaqësuesit të paditurës se kërkesëpadia e paditësve duhet të refuzohet për faktin se e paditura nuk ka mjete financiare që ti përmbushë këto detyrime ndaj paditësve, këto pretendime për gjykatën janë të pa bazuara për faktin se me nenin 2 të kësaj kontrate të gjitha DKA e institucioneve të arsimit të lart, në rastin konkret e paditura është e obliguar që ta zbatojë këtë kontratë kolektive dhe me kohë të planifikojë buxhetin me kohë për këto raste, e jo të thirret se nuk ka mjete të destinuara për këto raste, andaj edhe përgjegjësia në rastin konkret është tek e paditura e jo tek paditësit.

Vendimin për kamatëvonesë, gjykata ka vendosur që të llogaritet nga dita e pranimit të këtij aktgjykimit deri në pagesën definitive, në kuptim të nenit 382 të LMD-së.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës gjykata duke u bazuar në nenin 452 par 1 të LPK-së e ka obliguar të paditurën që paditësve t'ua paguaj shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 1,142.50 € (njëmijë e njëqind e katërdhjetë euro) dhe atë për përpilim të padisë shumë prej 312€, për përfaqësim në dy seanca shumë prej 810euro, për taksën gjyqësore për padi 60€, në ndërlidhje me Rregulloren për Tarifat e Avokatëve në fuqi.

Ndërsa gjykata e ka refuzuar kërkesën për shpenzime të procedurës, përtej shumës së aprovuar, si të pa bazuar, sepse nga arsyet e lartë cekura, gjykata që në fillim të këtij shqyrtimi i është referuar dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me thjeshtëzimin e procedurës, pasi çdo seancë gjyqësore e mbajtur, nuk nënkupton apriori që kërkesa për shpenzime të procedurës duhet të aprovuar me bindjen e suksesit të gjykimit të çështjes kryesore, ngase duhet vlerësuar edhe aspekti i "kontributit" që kanë krijuar shpenzime. Në këtë kuptim dispozita e nenit 450 të LPK-së, ka përcaktuar "*Secila palë paraprkisht vetë i bartë harxhimet që i ka shkaktuar me veprimet e veta procedurale*". Andaj gjykata nuk ka llogaritur shpenzimet për përfaqësim në seancën e datës 23.09.2020, pasi seanca është shtyer me arsyetimin që i autorizuari i paditësve do të konsultohet me paditësit për pajim gjyqësore, dhe në seancën e radhës i autorizuari i paditësve as nuk ka pranuar marrëveshje gjyqësore por as nuk e ka precizuar padinë, pra pasi seancat janë shtyrë sipas propozimeve të autorizuarit të paditësve që kanë qenë arsye e refuzimit të kërkesë për shpenzime, përtej kërkesës së aprovuar.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
C.nr.628/20 26 tetor 2020

Gjyqtarja
Mirlinda Bytyqi Rexhepi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.